



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

VENDIM

Nr. 176, Datë 25.04.2023

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
GJYQTARIT TË KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR Z.{...},
PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 01.01.2019-01.06.2020**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 68 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja “dh”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, datë 05.04.2023 “Rregullat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pas verifikimit të plotësimit nga gjyqtari z. {...} të kriterëve të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe pas shortit të realizuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-01.06.2020, për gjyqtarin e komanduar në Këshillin të Lartë Gjyqësor, z. {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve (Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në Këshillin të Lartë Gjyqësor).
2. Caktimin e znj. Irena Plaku si relatores për vlerësimin e gjyqtarit të komanduar z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR